



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**NDERMARRJA SHËRBIMEVE KOMUNALE DURRËS
NJËSIA E PROKURIMIT**

Durres më, _____.____.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE RROBA PUNE

VLERA E FONDIT LIMIT: 5.997.650 (pese milion e nenteqind e nentdhjete e shtate mije e gjashteqind e pesedhjete) leke pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja Shërbimeve Komunale Durres ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit dhe kualifikimit të parashikuara në piken 1, të shtojcës 7.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të paraqitur në autoritetet përkatëse, Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet. Kjo kërkesë konsiderohet e përrmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raportin negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përrmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvorje të nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

3. Operatori ekonomik ofertues te paraqese certifikatat qe vërteton se sistemi I kontrollit të

cilësisë së ofertuesit është sipas standartit.

3.1 Çertifikate personale ISO 9001:2015, te standartit nderkombetar te menaxhimit te cilesise dhe /ose te njevefshme, te cilat do te garantonin cilesine e produktit ose standart ISO me e avancuar, ku te jete i percaktuar objekti i prokurimit (e perkthyer e noterizuar). Çertifikatat duhet te jene te vlefshme dhe te lëshuar nga organizmat te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetar akreditues te njohur nga Republika e Shqiperisë.

3.2 Çertifikate personale ISO 14001:2015, te standartit nderkombetar i menaxhimit te mjedisit dhe /ose te njevlefshme,ose standart ISO me e avancuar, ku te jete i percaktuar objekti i prokurimit (e perkthyer e noterizuar). Çertifikatat duhet te jene te vlefshme dhe te leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetar akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kriteri që OE duhet të disponojë Çertifikate ISO 9001: 2015 (e vlefshme) ose ekuivalente me të, ”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së furnizimit me mallra që ofron.

Menaxhimi i cilësisë i çertifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë sjell besim tek partneret e biznesit dhe autoritetet në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogelimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në tërësi.

ISO 9001 përfaqëson standartin nderkombetar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

3.3 Operatori ekonomik ofertues, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Autoritetit Kontraktor, pranë NSHK Durrës, duhet të paraqesë të paketuara dhe të protokolluara mostra për të gjitha mallrat objekt prokurimi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmërinë e specifikimeve të kërkuara dhe të kryejë analizat e nevojshme laboratorike nëse do të shihet e arsyeshme.

Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s’kualifikimi për vazhdimin e procedurës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar, në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, Vetë Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me këtë kriter, arsyeton: ...”KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave për disa prej produkteve objekt prokurimi...”Qëllimi i

vendosur nga ligjvënësi përparaqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

3.4 Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të artikujve: 1.Kepuce sigurie;2. Pantallona+Xhakete; ,të lëshuara nga laboratorë të akredituar ne Republiken e Shqiperise sipas standarteve kombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti kontraktor e vlereson te nevojshme kërkesat e mesiperme , duke qene se nuk kemi nje specialist tekstili certifikatat e konformitetit dhe raport testimet permbajne te dhenat teknike dhe sipas stanrtave te kerkuara.

3.5 OE ofertues duhet te paraqese certificate konformiteti produkti per artikujt: Xhup 3/1 dhe Pelerine shiu, sipas standarteve EN 343:2003+A1:2007; EN ISO 20471:2013 ; EN ISO 13688:2013ne menyre qe te veretohet cilesia e tyre me specifikimet teknike te kerkuara ne DT.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti kontraktor e vlereson te nevojshme kërkesat e mesiperme , duke qene se nuk kemi nje specialist tekstili certifikatat e konformitetit dhe raport testimet permbajne te dhenat teknike dhe sipas stanrtave te kerkuara.

3.6 OE ofertues duhet te paraqese skeda teknike/katalog per produktet e ofruara ku te perputhen me specifikimet teknike e kerkuara .

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti kontraktor e vlereson te nevojshme kërkesat e mesiperme , duke qene se nuk kemi nje specialist tekstili certifikatat e konformitetit dhe raport testimet permbajne te dhenat teknike dhe sipas stanrtave te kerkuara.

SPECIFIKIME TEKNIKE

1. Xhup 3/1

Xhup dimeror me dukshmeri te larte (tre pjese ne nje, secila pjese te disponoje dukshmerine e larte): pjesa e sipërme te mos depertoje shiun dhe eren, te siguroje mbrojtje te gjithanshme ndaj kushteve te motit. , peshe 190gr/m2, me 4 xhepa te gjere te perparme me palosje, ku nje xhep i vogel, unazë mbajtëse per karte pune ne pjesen e jashtme, te kete mbyllje me dopio zinxhir, 100% poliester poliuretano, astar i brendshem 100% poliester120gr/m2 me imbotiture; kapuc i levizshem i cili mund te pershtatet lehtesisht dhe te kycet te kete mundesi pershtatjeje;

pjesa e dyte te jete me minge te levizshme, pesha 120gr/m2, xhep ne kraharor i mbyllur me zinxhir, te jaka dhe kycet te kete elasticitet, dy xhepa të përparmë me zinxhir, unazë mbajtëse per karte pune, kapuç te rregullueshem e te levizshem, copa e jashtme 100% poliester poliuretano, astar i brendshem 100% najlon me imbotiture. Xhupi 3-1nga pjesa e gjoksit dhe shpines e siper duhet te jete ngjyre e verdhe floreshentedhe pjesa e poshtme jeshile ne te erret.

Mbrojtje e gjithanshme ndaj kushteve te motit. Sipas normative SSH EN 342; SSH EN ISO 20471 klasi 2. SSH EN 343 klasi 3,ose ekuivalente, CERTIFIKIMI

Ngjyra e verdhe floureshente e kombinuar me jeshile te erret.

Te jene me logo te institucionit.

2. Cizme llastiku

Çizme gome me ngjyre **blu ose jeshile** me përbërje 100% polivinil klorid (PVC) me një shtresë tekstili push në anën e brendshme, gjatësia e çizmes deri në kupën e gjurit ,e padepërtueshme nga vaji, me shollë me lule. Material i sholles sitentik i patentuar. Lartesia e cizmes duhet te 33(ne varesi te mases). Lartesia e sholles perpara 1.6 cm dhe ne thember 3 cm. Te jene te prodhuar me PVC. Ti rezistojne ndryshimit te temperatures se ambientit te punes. Te jene te pershtatshme per te punuar ne ambiente me prezence te vajrave lubrifikante, karburanteve, etj. Ngjyra e çizmeve te jete blu ose jeshile Cilesia e larte. Prodhimi i çizmeve te jete bere jo me pare se tre muaj nga koha e levrimit.

3. Kepuce sigurie

Kepuce te mbrojtjes ne pune, forme atlete pa qafe, me pore steelite S3 me linje speciale ajrosje sipas standardit SSH EN ISO 20345 S3Rezistente ndaj vajrave dhe hidrokarbureve. Rezistente ndaj rreshqitjeve. E veshur me material kunder goditjeve 200J teknologjia PU dendesi e dyfishte, antistatike dhe anatomike poliuretani i bute i mbuluar me pelhure absorbuese dhe me ajrosje me 3 shtresa per transferimin e lageshtise ne pjesen e jashtme dhe tharje te shpejte ., Perdorimi te jete i thjeshte dhe kempa te ndjehet komode gjate perdorimit duke ruajtur anen shendetsore te perdoruesit. Gjate perdorimit te jete rezistent ndaj djersitjes te mbushura me material per rehati te kockave dhe kyceve te kembes. Mbyllja me lidhese. Lekure bualli ujiduruese

- ☐ Certifikim CE
- ☐ Mbrojtjesja e gishtave kompositë për një mbrojtje maksimale
- ☐ Shollë e mesme anti-shpim kompositë me shtresë të butë PU
- ☐ Membranë 100% ujëdaluese
- ☐ Shollë anti-rreshkitje (SRC) për të parandaluar rrëshkitjen në qeramike dhe celik.
- ☐ Shollë rezistente ndaj vajrave
- ☐ Shuall me densitet të dyfishtë
- ☐ Përshtatje e gjerë
- ☐ Peshë e lehtë
- ☐ Rrjete ajrosese 3D
- ☐ Shtrese mbrojtëse TPU te gishtat për rezistencë më të lartë
- ☐ Lekurë e plotë me trashësi 1.8ml

Ngjyra/Fit/Size gri e errët/zeze

Artikulli duhet të jetë sipas Standarteve SSH EN ISO 20345 S3, ose Ekuivalente, CERTIFIKIMI

4. Kominoshe dimri

Uniforma e punës dyngjyreshe ngjyrë e verdhe floureshente (HV)dhe jeshile e erret me shtresa, materiali të jetë 100% poliesterpesha 190gr/m2 veshur me Dopje PU antinjolle. Me veshje te ngrohte dhe higjenike nga brenda ne pjesen e belit dhe poshte material poliester 60g . Në pjesën e shpinës veshja e punës te jete përbërë me rripa, e cila ndihmon përdoruesin të përkulet lehtësisht pa ushqetësuar. Me zinxhir plastik. Me 1 xhep në pjesën e krahavorit, 2 xhepa anësore, 2 xhepa nëpjesën e mbrapme si dhe 1 xhep ne pjesen e anes kofshes majte me kapak. Me 2 shirita fosforeshente 5 cm ne pjesen e poshte gjurit. E gjithë pjesa e bustit deri te gjuri duhet ngjyre e jeshile erret, ndersa pjesa poshte verdhe floreshente Ne pjesen e parmeduhet te kete logon e nderrmarjes.

- Pelhure shume rezistente me mbrojtje ekselente nga c'ngjyrosja
- Pelhura e klasifikuar me UPF 50+ per te bllokuar 98% rrezeve UV
- 6 xhepa per hapsire mbajtese me te madhe

- Xhep telefoni
- Pjesa mbrapa me llastik
- Te gjithë tegelat me qepje te forte dhe me suzator nga brenda

Mbrojtje e gjithanshme ndaj kushteve te motit. Sipas normative; SSH EN ISO 20471 klasi 2. SSH EN 343 klasi 3,2ose ekuivalente, CERTIFIKIMI

5. Kominoshe vere

Kominoshe e punes me rripa e përbere nga material 65% Poliester dhe 35% Pambuk, pesha 245gr/m2. Ngjyra jeshile e erret pjesa e bustit deri te gjuri dhe e verdhe floreshente pjesa poshte gjurit, te jete e ngrohte, higjenikisht shume e paster .

- Pelhure shume rezistente me mbrojtje ekselente nga c'ngjyrosja
- Pelhura e klasifikuar me UPF 50+ per te bllokuar 98% rrezeve UV
- 6 xhepa per hapsire mbajtese me te madhe
- Xhep telefoni
- Pjesa mbrapa me llastik
- Te gjithë tegelat me qepje te forte dhe me suzator nga brenda
- Mbrojtese zinxhiri

Pelhure kryesore: - 65% Poliester, 35% Pambuk 245gr/m2

SSH EN ISO 20471 klasi 2 Veshje mbrojtëseose ekuivalente, CERTIFIKIMI

Pantallona+XHAKETE

Pantallona me dukshmeri te larte, 35% pambuk 65% polyester, pesha 245gr/m2,Ngjyre jeshile e erret pjesa deri te gjuridhe verdhe floreshente pjesa poshte gjurit, xhepa perpara te pjerret dhe 1 xhep me kapak ne pjesen e siper gjurit ne anen e majte, dy shirita fosforeshente me dukshmeri te larte, 1 xhep ne pjesen pas, me bel me llasik me mundesi pershtatjeje, sipas normativave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune, Me logo te institucionit.

Xhaketame dukshmeri te larte, 35% pambuk 65% polyester, pesha 245gr/m2,Ngjyre jeshile e erret pjesa e gjoksit shpines dhe e verdhe floreshente pjesa poshte, 2 xhepa perpara pllake me kapak dhe 2 xhepa siper me kapak te gjere dy shirita fosforeshente me dukshmeri te larte, sipas normativave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune, Me logo te institucionit.

6. Jelek fosforeshent

Jelek material polyester, veshje pune fosforeshente me dukshmeri te larte, rezistente ndaj ujit dhe temperaturave te ulta, praktike profesionale me 2 shirita gri fosforeshente,. Sipas direktives SSH EN 340 ose ekuivalente, CERTIFIKIMI me etiketen e firmes prodhuese te trupezuar per udhezimin e perdorimit.

7. Doreza sigurie

Mbështjellje polietileni me performancë të lartë. Përforcimi TPR(Thermo Plastic Rubber) në shpinë dhe në majë të gishtave. Materiali kryesor për dorezat e mbrojtjes nga goditja eshte TPR Dokumentat Standarde të Tenderit (Gome Plastike Termike). Elasticiteti I gomës e bën atë zgjedhjen ideale për sigurimin e mbrojtjes së dorës, ndërsa gjithashtu ofron fleksibilitet të plotë dhe lirshmeri të lëvizjes. Me veshje nitrili në pëllëmbë dhe në majë të gishtave. Përforcimi i brendshëm i stampuar në pëllëmbë. E veshur me nje shtrese akrilik nga brenda. Fije Kevlar në të gjitha shtresat. Rregullorja e BE 2016/425, me kërkesat e saj dhe me standardet e harmonizuara:

RREGULLORE (BE) 2016/425

SSH EN420: 2003 + A1: 2009 Kërkesa të përgjithshme

SSH EN388: 2016 Doreza mbrojtëse ndaj rreziqeve mekanike (Nivelet e marra në pëllëmbë)

ose ekuivalente, CERTIFIKIMI

4: Rezistenca ndaj konsumimit (nga 1 në 4)

X: Rezistenca ndaj prerjes (nga 1 në 5)

4: Rezistenca ndaj grisjes (nga 1 në 4)

4: Rezistenca ndaj shpimit (1 deri në 4)

D: Rezistenca ndaj prerjes nga objekte të mprehta (TDM EN ISO 13997) (nga A në F)

P: Mbrojtja ndaj ndikimit në zonën metakarpale (P) (EN13594: 2002 6.8.2)

EN511: 2006 Doreza mbrojtëse kundër të ftohtit (X = provë e përealizuar)

1: Rezistenca ndaj të ftohtit konvektiv (nga 1 në 4)

3: Rezistenca ndaj të ftohtit (nga 1 në 4)

X: i papërshkueshëm nga uji (0 ose 1)

8. Doreza pune

Doreza pune për grumbulluesit e mbeturinave me përzierje 35% pambuk+35% poliestër +30% poliuretani Trashësi 0.6-0.8 mm Qendrueshmëri e ngjyres Nota 4; masa 300 gr/m². Pjesa e jashtme e pellembeve të dorës dhe e gishtërave të jetë e gomuar, pjesa e brendshme dhe ajo e jashtme beze pambuku. Të kenë gjatësi deri të kyçit me gjatësi 6 cm me përzierje pambuk i thurur elastik.

SSH EN 420. SSH EN 388. 2003ose ekuivalente, CERTIFIKIMI

9. Pelerinë shiu

Pelerinë shiu me shirit reflektiv duke përdorur pëlthurë të lehtë, kjo pelerinë është plotësisht

i papërshkueshëm nga uji, gjithashtu përmban një kapuç të ambalazhuar, xhepa për ruajtje të

sigurtë, si dhe unaza dhe çarje shpinë e pasme për të shtuar ajrosjen.

☐ Pëlthurë e lehtë ujëduruese me qepje të izoluar për të ndaluar penetrimin e ujit

☐ Qepje hermetike me shirit për mbrojtje më të madhe

☐ Shirit reflektues për më shumë dukshmëri

☐ Hapje me zinxhir para

☐ 2 xhepa për hapsirë të sigurtë

☐ Kapuç që paloset nën jakë

☐ Mëngë elastike nga brenda

☐ Vrima dhe hapje mbrapa për ventilim dhe rehati

☐ Sipërfaqja e pëlthurës është ekstremisht ujë rezistuese, duke e shpërndarë ujin nga

sipërfaqja e pëlthurës.

☐ Të ketë logot e autoritetit para majtas, në shpinë dhe mëngë e majtë.

Përmbajtja 100% Poliestër, e Veshur me PVC 210g

Ngjyra/Fit/Size blu e errët/ jeshile erret Nr. S - 3XL

Artikulli duhet të jetë sipas Standarteve SSH EN ISO 343:2019 CLASS 3.1 ose ekuivalente, CERTIFIKIMI

Kapele

Kapele ngjyra e Jeshile , masa 220 gr/m2, trashesia 0.5mm, qendrueshmeria e ngjyres Nota 5 thurja sarzh diagonal 2/1, 35% pambuk 65% polyester ne pjesen ballore te jete e stampuar logo

Ne te gjitha Veshjet ne pjesen e kurrizit do te stampohet Logo e Ndermarrjes si meposhte:



BASHKIA DURRES

NSHK

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet Teknike të mësipërme janë në përputhje me nenet: Neni 4, pika 38/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2; 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Theksojmë se ‘Specifikimet Teknike’ i shërbejnë AK për të patur garanci se malli i ofruar do të jetë në parametrat dhe në cilësinë e duhur.

Shënim: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi janë hartuar nga grupi i punës ngritur me urdher nr. 24, date 17.01.2023, miratuar nga titullari i AK, bazuar në parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhenenit 36, të LPP, si dhe nenit 42 dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo dhe çdo standardi të kërkuar.

Afati i levrimit: nga data e lidhjes se kontrates deri me date 30.09.2023.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT

Krisel Koça

Iva Qehaja

Ledia Xhufka

GRUPI I SPECIFIKIME TEKNIKE

Migen Rroqja

Borana Loli

Elgi Koni

Rudolf Kavaja

Dritan Dedja